



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe të nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, sipas kërkesës së Zyrës amerikane për caktimin e lokacionit të mundshëm, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007 merr këtë

V E N D I M

- I. Si lokacion i mundshëm për ndërtimin e Zyrës amerikane t'i propozohen lokacionet:
 - pjesën e ngastrave kadastrore nr. 7183, 7184, 7185, 7186, 7187 dhe 7506, në sipërfaqe përafërsisht prej 5.80 ha, e evidencuar si pronë e Komunës së Prishtinës, e përfshirë në Planin rregullues "Arbëria 3";
 - pjesën e ngastrave kadastrore nr. 1665, 1666, 1667, 1668, 1677, 1679, 1680, 1681, 1682 dhe 1683, me sipërfaqe prej 11.72.51 ha, e përfshirë me planin e ardhshëm rregullues "Prishtina e Re";
 - pjesën e ngastrave nr. 535, 544, 545 dhe 547, me sipërfaqe të përafërt 13.00.00 ha, e përfshirë me planin e ardhshëm rregullues "Prishtina e Re".
- II. Lokacionet, nga pika 1 e këtij Vendimi, i ofrohen Zyrës amerikane për qëllimin e hulumtimit paraprak nga aspekti i pozitës së lokacioneve ndaj infrastrukturës përkatëse rrugore, si dhe përshtatshmërinë nga aspektet tjera urbanistike dhe teknike.
- III. Pas hulumtimeve përkatëse të përshtatshmërisë së këtyre lokacioneve, Zyra amerikane do ta informojë Komunën e Prishtinës lidhur me rezultatin dhe mendimin përkatës, në përputhje me përshtatshmërinë e këtyre lokacioneve për nevojat e ndërtimit të kësaj zyreje.
- IV. Pas konfirmimit për përshtatshmërinë e njërit prej këtyre lokacioneve, të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi, të dedikuara për ndërtimin e Zyrës amerikane, Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë do të bëjë caktimin e lokacionit nga aspekti i planifikimit hapësinor, si dhe do të rregullojë mënyrën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit të përshkruar më lart.

KUVENDI I KOMUNES SË PRISHTINËS

01. Nr.353-203, më 17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri